

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuares S.K nga ..., per shkak te vepres penale mashtrim nga neni 335 par.1 te KP-es, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.3330/2014 të datës 17.05.2016, pas mbajtjes së seancës kryesore publike, në prezencën e Prokurorit Themelore te shtetit në Prizren Beqë Shala, të akuzuares, me datë **18.08.2017**, morri dhe shpalli publikisht këtë:

AKT GJYKIM

E akuzuara **S.K**, nga i ati F..., e ëma N..., e vajzërisë ..., e lindur më datë ... në ..., ku edhe tani jeton ne rr. ... nr...., ka të kryer shkollen e larte te kryer, e pamartuar, e pa pune, e gjendjes se dobet ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Se me dt.21.07. 2014, ne Prizren ne agjencionin turistik “...” me qellim per ti sjell vehtes dobi pasurore, e sjell personin tjetër ne lajthim me ane te paraqitjes se rreme, apo duke e fshehur faktet dhe me kete e shtyt personin e tille qe te veproje ne dem te pasurise se tije, ne ate menyre qe e demtuara A.M, ben rezervimin per pushim veror 10 ditore per ne Bodrum te Turqis, ku paguan shumen prej 420,00 euro, ku me dt.08.09.2014, pasi shkon ne aeroportin Adem Jashari ne Sllatine, kupton qe bileta ishte jovalide – false,

- kesodore ka kryer vepren penale mashtrim nga neni 335 par.1 te KP-es,

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 42, 43, 46, 49 par.1 p.1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 e 76 te KPK-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ne lartesi prej **300 /treqindë/ Euro** te cilen shume te denimit e akuzuara eshte e obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, e akuzuara denimin me gjobe do te paguaj ne 3 kiste, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim e njejta do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, respektivisht 15 dite burgim dhe,

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i verteton denimin me burgim ne kohezgjatje prej **1 /nje/ viti** i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej **2 /dy/ viteve** nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese e akuzuara nuk do te kryen ndonje veper te re penale.

E akuzuara obligohet qe te paguaj shpenzimet e procedures penale sado qe te jene ato, ne emer te shpenzimeve te paushalit gjyqesor shumen prej **50,00 euro**, ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtuar aktakuzen me PP.nr.3330/2014 te dt.17.05.2016, kunder te akuzuares S.K nga ..., per shkak te vepres penale mashtrim nga neni 335 par.1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim kryesore ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares e cila vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se e akuzuara ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila iu vihete ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuzen, per te cilat e akuzuara ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuzen, ne veprimet e te akuzuares formohen te gjitha elementet e vepres penale mashtrim nga neni 335 par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe e kusht si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e saje penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuares gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i saje, ne kuptim te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin se e akuzuara ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i saje ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, e pa pune, e gjendjes se dobet ekonomike, mbajtese e familjes 3 anetaresh, te demtuars ia ka kompenzuar demin e shkaktuar, andaj gjykata iu shqiptoi denimin me gjobe e me kusht sepse konsideron se me me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se saje dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete e kujdesshme dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 1023/2016 të datës 18.08.2017

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.